

## FJALA E DEPUTETES JORIDA TABAKU

21 MARS 2024

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë, që pas 6 muajsh po prisni me shumë kërshtëri diskutimet në Parlament,

Se kush flet për shqiptarët dhe kush flet për interesin e vet, besoj se shihet edhe në këtë sallë të Parlamentit, e kemi parë për vite me radhë, por nuk besoj që sot është e nevojshme t'ua kujtojmë qytetarëve. Ne kemi përpara një akt normativ, që ka ardhur dy muaj pas fillimit të vitit dhe është ndryshimi i parë i buxhetit. Qëllimi dhe arsyeja e vërtetë pse ka ardhur ky akt normativ shprehen në ndryshimin e fondeve për portin e Durrësit, që e përmendën edhe disa kolegë këtu. Është një rishikim i buxhetit, i cili vjen menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit për taksën e profesionistëve të lirë, që nga data 1 prill do të jetë një realitet i ri për 30 mijë profesionistët e lirë të cilët operojnë dhe punojnë në Shqipëri. Kur pothuajse 2 vjet më parë ne diskutuam 14 orë në Parlament për kontratën e portit të Durrësit, për vendosjen e portit të Durrësit diku tjetër, qeveria mbrojti me këmbëngulje të verbër retorikën se porti i ri nuk do të ndërtohej me fondet e buxhetit të shtetit. U bënë takime me donatorë, u bënë konsultime me bankat zhvilluese, u bë prezantimi i projektit dhe u tha, ashtu siç thoshte, në fakt, edhe specialisti i buxheteve që sot është në kërkim ndërkombëtar, se asnjë lek nuk do të dalë nga buxheti i shtetit për të ndërtuar portin e ri.

Kështu që, kjo retorikë boshe duke përmendur NATO-n, duke thënë se ne jemi kundër zhvillimit dhe çdo fantazi tjetër, që nuk ka dalë kurrë nga goja e askujt, të paktën nga opozita, unë besoj se nuk ka vlerë të diskutohet sot në këtë Parlament, sepse fakti është se ndryshimi i parë që erdhi për buxhetin e shtetit kalon pothuajse 80 milionë euro, për shumën totale të portit të Durrësit, në 390 milionë euro. Ky është një realitet i ri në buxhetin e shtetit, që u premtua se nuk do të ndodhte, u premtua se nuk do të ishte kjo mënyra si do të ndërtohej porti i ri i Durrësit. Pak a shumë e njëjta skemë u përdor edhe për Teatrin Kombëtar. U premtua që teatri do të ndërtohej me fonde, erdhi në këtë Parlament me një ligj special, por si përfundim edhe teatri do të ndërtohet po me të njëjtën skemë. E njëjta skemë u përdor edhe me tri ligjet e ndryshuara për interesa aspak publike, aspak të të gjithë shqiptarëve, por tërësisht klienteliste.

Ligji “Për zonat e mbrojtura”, që na u shit si kërkesë e disa kryebashkiakëve përmes deputetëve, në të vërtetë rezultoi se kishte në bazë të tij vetëm investimet strategjike në zonat e mbrojtura. Me një procedurë ekstraparlamentare, duke zhbërë të gjitha dëgjuesat publike me shoqatat e mjedisit dhe me qytetarët, në këtë sallë u ngritën kartonët verbazi, siç u ngritën për portin e Durrësit apo për Teatrin Kombëtar. Më pas, me të njëjtën formulë u shty për herë të pestë ligji “Për investimet strategjike”, që në 75% të rasteve ka dhënë leje për ndërtimin e resorteve turistike në Jug të Shqipërisë, edhe në zona të mbrojtura. Zona e mbrojtur e Butrintit është njëra prej tyre. E fundit, por jo për nga rëndësia, ligji që merret me menaxhimin e zonave bregdetare është për të njëjtit përfitues. Unë nuk po them se në këta 30 vjet nuk ka pasur ndërtime në zonat e mbrojtura, të cilat janë rritur në mënyrë eksponenciale, në fakt, nga aeroporti i Vlorës deri te hidrocentralet. Ato mund të hiqeshin dhe Shqipëria do të arnohej copa - copa, siç ka ndodhur sot rëndom nga Vlora deri në Butrint, mirëpo këto veprime hasin në dy probleme të mëdha. Së pari, është angaria për të mbledhur grupe pune për t'i përdorur si justifikim dhe, nga ana tjetër, është përgjegjësia që del nga firma e këtyre zyrtarëve. Për rrjedhojë, zgjidhja inteligjente që zbuloi qeveria ishte ajo e heqjes së përgjegjësive: nga përgjegjësia individuale, ia kalojmë Këshillit Kombëtar të Territorit; nga përgjegjësia e drejtorëve, ia kalojmë Parlamentit; nga përgjegjësia e ministrave, ia kalojmë përgjegjësive kolektive. Kjo ka ndodhur me këto tri ligje, kjo ka ndodhur si tendencë vitet e fundit dhe pikërisht kjo ia zbeh dhe ia zhvlerëson vlerën, edhe aq sa i ka mbetur, këtij Parlamenti. Më vjen keq, të

nderuar kolegë të paktë që keni ngelur në këtë sallë, por të tria këto ligje tregojnë atë që themi prej vitesh, pikërisht bërjen e ligjeve me porosi, sikundër dëshmojnë edhe frikën që kanë sot nga drejtësia. Në të tria ligjet ka vetëm një tendencë: përgjegjësia kolektive përballë asaj individuale.

Të tria këto ndryshime ligjore erdhën kur në mediet ndërkombëtare u njoftua njëkohësisht edhe interesi për të zhvilluar zonën e Sazanit dhe u konfirmua se tashmë është edhe në planin e qeverisë t'i japë leje një kompanie serioze për ndërtimin e resorteve turistike. Duke qenë se kam folur gjatë për mungesën e investimeve serioze të huaja, për garën e humbur me të gjitha vendet e rajonit për investimet e huaja serioze, por njëkohësisht edhe për vendet e humbura të punës, si rezultat i mungesës së tyre, unë besoj se sot qeveria po e shikon gabim edhe ekonominë, edhe turizmin, dhe po vepron përsëri gabim. Që të pretendojmë të marrim investime serioze amerikane, e para, ne duhet të respektojmë pronën publike, pronën private, dhe rregullat elementare të tregut të lirë, që i kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mund të kishte një garë publike, me kriteret e hapura, transparente, mund të kishte një proces për të cilin të kishim dijeni të gjithë ne, por jo të bëhet fakt i kryer marrja e një projekti pasi janë ndryshuar tri ligjet. Meqenëse ky projekt paska qenë kaq strategjik dhe kaq i rëndësishëm për Shqipërinë, pse nuk erdhi për t'u diskutuar këtu dhe të thuhej që na pengojnë këto tri ligje për ta bërë këtë investim?! A është më normale të hapim një diskutim publik për të mirën publike, se si duhet të veprojmë në këto raste, apo duhet ta bëjmë fakt në Parlament, pasi ngrihen kartonët dhe pasi përdoret Parlamenti? Kjo nuk do të thotë aspak që turizmi nuk duhet të zhvillohet, por ky zhvillim duhet të vijë duke zbatuar rregullat, duke zbatuar ligjet dhe, së pari, duke zbatuar parimet dhe standardet. Nuk mund të kemi një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe as zhvillim real ekonomik e profesional në këtë situatë që ndodhemi sot.

Çfarë ka bërë qeveria e Shqipërisë 12 vjetët e fundit, për të tërhequr një investim të vetëm serioz? Në listën e 44 investimeve strategjike, vetëm një prej tyre i plotëson kushtet e një investimi serioz: fabrika që ndodhet sot në Fier. Çfarë ka bërë Shqipëria, që është në qendër të dheut, për të tërhequr tendencat e fundit të teknologjisë së informacionit? Sa ka investuar Shqipëria për të qenë konkurrenë në atë që ka avantazh konkurrues? Ndërkohë dëgjojmë oferta qesharake, të tilla si: do të rrisim fondet për trajnime në arsimin profesional. Prej kohësh unë nuk kam dëgjuar të flitet as për vizion ekonomik, as për strategji për zhvillimin e turizmit dhe për asgjë që të ketë lidhje me atë çka sot duhet të jetë Shqipëria, për t'i paraprirë rritjes së numrit të turistëve, që me të vërtetë ka ndodhur dhe po ndodh, por fatkeqësisht nuk po reflektohet në ekonomi, sepse konsumi po bie, ashtu siç ka rënë në kulmin e turizmit, dhe nuk po reflektohet as në standardet e bizneseve të vogla e të mesme, që e kanë ofruar turizmin ndër vite. Në datat 21-22 mars do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Europian, por, fatkeqësisht, Shqipëria nuk është në agjendë. E kemi humbur mundësinë të hapim negociatat këtë vit dhe unë prisja të jepej një shpjegim në këtë Parlament. E humbëm mundësinë për ta vendosur procesin e integritimit në krye të reformave dhe ta kemi atë si promotor të zhvillimit të vendit, që çdo gjë që zhvillohet në Shqipëri dhe çdo ligj që kalon në Parlament të ketë atë frymë, pavarësisht se ndoshta ndodhemi të paktën 10 vjet pas në hapa dhe reforma.

Në vend që ky Parlament të kalonte ligje të tilla me porosi, unë sot prisja të diskutonte se çfarë duhet të bëjmë ne për të luftuar korrupsionin, se nuk mjafton vetëm ndëshkimi, por ne duhet të merremi edhe me parandalimin. Çdo ligj që miratohet në këtë Parlament, duke filluar nga prokurimet publike deri te koncesionet, duhet të ketë frymën dhe standardin e ligjeve të Bashkimit Europian. Tatimet, doganat, koncesionet, prona dhe kadastra janë fusha për të cilat opozita nuk ka ndenjtur, por ka propozuar edhe iniciativa ligjore. Në sa e sa raste kam ardhur këtu dhe i kam diskutuar në emër të grupit parlamentar, por janë rrëzuar me forcën e kartonëve. Kështu që, kur vini dhe na jepni mend se çfarë duhet të themi dhe se si duhet të veprojmë, duhet të keni parasysh se çfarë po bëni edhe ju në këtë drejtim. Besoj se sot Shqipëria ka nevojë për një kthesë rrënjësore për të luftuar korrupsionin dhe nuk pres që këtë gjë ta bëjë

qeveria, e cila shpenzon më shumë kohë në SPAK sesa në zyrat e saj. Sot është e nevojshme ta luftojnë korrupsionin ata që kanë moral. Për luftën ndaj korrupsionit, nuk mund të flasin ata që sot i kanë zyrtarët të rreshtuar përpara drejtësisë. Parlamenti duhet të dalë mbi interesat personale të secilit, edhe mbi interesat politike e partiake, dhe të vazhdojë me procesin e integritetit, megjithëse jemi pas, me oferta konkrete për ta ndryshuar këtë mentalitet, për ta ndryshuar këtë filozofi. Kjo gjë duhet të fillojë nga Parlamenti, me mosmiratimin e këtyre ligjeve me porosi, për të cilat ngrihen kartonët verbtazi, siç ndodhi për aktin normativ sot, për buxhetin herën e kaluar, pesë herë për investimet strategjike dhe për 12 ligje të tjera. Te vullneti politik fillon lufta ndaj korrupsionit, që nuk e ka pasur dhe nuk ka pse ta ketë sot qeveria.

Faleminderit!